

BULETINI

TETOR 2025



YOUTH
Empowered
through Inclusive
Schools and Societies
(YESS)





Përfundimi me sukses i Ciklit të Tretë të Kampeve Rinore të ACDC

Nga 17 deri më 19 tetor 2025, OJQ ACDC organizoi ciklin e tretë të kampeve rinore në Brezovicë. Të rrethuar nga peizazhe vjeshtore, të rinj nga komunitete të ndryshme u mbledhën për të mësuar dhe eksploruar fuqinë e gjuhës dhe dialogut në ndërtimin e mirëkuptimit të ndërsjellë. Kampi demonstroi se gjuha dhe kultura janë mjete kyçe për krijimin e një shoqërie më tolerante dhe forcimin e besimit midis të rinjve.

Ky program është realizuar në kuadër të projektit "Të rinjtë e fuqizuar përmes shkollave dhe shoqërive gjithëpërfshirëse (YESS)", i financuar nga Fondi i Ndërtimit të Paqes i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe i zbatuar nga UNICEF dhe IOM Kosova.






Brenda kampeve rinore, u nisën iniciativa të reja për të vazhduar bashkimin e të rinjve përmes projekteve të ndryshme në të gjithë Kosovën. Në kuadër të projektit “Së bashku për të nesërmen: Iniciativa Rinore në Kosovë”, u organizuan aktivitete që lidhën shkencën, natyrën dhe kulturën.

Pjesëmarrësit e rinj nga disa komuna morën pjesë në programe ku eksploruan astronominë me mbështetjen e Klubit të Astronomisë së Kosovës — duke vëzhguar Diellin, Hënën dhe planetët, dhe duke mësuar përmes ligjëratave interaktive në Observatorin në Prishtinë.

Programi përfshinte gjithashtu vizita në monumente kulturore dhe natyrore si Muzeu Arkeologjik në Prizren, Manastiri i Graçanicës dhe Pylli e Arinjve, duke u lejuar pjesëmarrësve të fitonin njohuri të reja rreth historisë, kulturës dhe mbrojtjes së mjedisit.

Të gjitha aktivitetet kontribuan në qëllimin kryesor të projektit — nxitjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërkulturor midis të rinjve nga komunitete të ndryshme në Kosovë.



Trajnim mbi Identifikimin dhe Reagimin ndaj Dhunës Seksuale dhe Dhunës me Bazë Gjinore

Gjatë tetorit, OJQ ACDC organizoi sesione trajnimi kushtuar njohjes, reagimit dhe parandalimit të ngacmimit seksual dhe dhunës me bazë gjinore. Trajnimet mblodhën së bashku përfaqësues nga gjyqësori, prokuroria, policia, Inspektorati i Policisë dhe sektori civil, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit institucional dhe mbështetjen e viktimave.

Pjesëmarrësve i'u drejtuan gjithashtu përfaqësues të Fondit Kanadez për Iniciativa Lokale (CFLI), i cili mbështet zbatimin e projektit "Thyerja e Heshtjes: Luftimi i Ngacmimit Seksual dhe Dhunës me Bazë Gjinore në Veri të Kosovës".



Sesione informuese për oficerët e policisë mbi gjuhën e urrejtjes dhe lirinë e shprehjes

Në tetor, OJQ ACDC organizoi dy sesione informuese për zyrtarët e policisë në veri të Mitrovicës dhe në Prishtinë mbi temën e dallimit midis gjuhës së urrejtjes dhe lirisë së shprehjes.

Sesionet u drejtuan nga Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë, i cili theksoi rolin e rëndësishëm të policisë në mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të të gjithë qytetarëve. Aktivitetet u zhvilluan në kuadër të projektit "Promovimi i Besimit përmes të Drejtave të Njeriut", të zbatuar nga OJQ ACDC me mbështetjen e UNMIK-ut.





Të rinjtë për lumenj të pastër

OJQ ACDC në fund të tetorit lansoi projektin “Të rinjtë për lumenj të pastër”, duke organizuar seanca trajnimi mbi mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e ujit. Përmes diskutimeve, punëtorive dhe shembujve praktikë, pjesëmarrësit e rinj eksploruan mënyra për të kontribuar në një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm. Trajnimet u zbatuan me mbështetjen e GIZ, në kuadër të Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë (KSDW).

Marrëveshje Bashkëpunimi e Nënshkruar me ATRC

Në tetor, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi midis ACDC dhe ATRC, e cila parashikon zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta informuese dhe edukative për të rinjtë nga komunat veriore të Kosovës.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit të të rinjve për të drejtat e pronës, proceset e legalizimit dhe regjistrimit, si dhe rëndësinë e dokumentacionit formal të pronës.



Në tetor 2025, ACDC lëshoi dy deklarata publike: E para dënoi vendimin e KQZ-së për t'ua mohuar akreditimin gazetarëve nga komuniteti serb, duke e quajtur vendimin një akt diskriminimi dhe një sulm ndaj lirisë së medias.

[SRB](#)

[ENG](#)

[ALB](#)

E dyta, së bashku me shoqërinë civile, i bëri thirrje KFOR-it të marrë përgjegjësinë për sigurinë në veri të Kosovës pas një incidenti që përfshinte anëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

[SRB](#)

[ENG](#)

[ALB](#)

OJQ ACDC monitoroi zgjedhjet lokale në Kosovë

Ekipi i ACDC vëzhgoi gjithashtu zgjedhjet lokale të mbajtura më 12 tetor 2025. Drejtori i organizatës, Dušan Radaković, u shpreh me mediat në lidhje me procesin zgjedhor.

Deklarata më të hollësishme janë të disponueshme në vegëzat e mëposhtme:



Медија центар
Qendra mediale
Media Center
Чаплица – Çagllavicë



Danas



KONTAKTI



office@acdc-kosovo.org



@acdc.kosovo



www.facebook.com/Ngoacdc



@ngo_acdc



www.acdc-kosovo.org

